

IT - s

Z. se Statistikave

Sk 1188 Prot  
19.05.2020



REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Nr. 838/Prot.  
156

Tiranë, më 15/05/2020

**Lënda:** Trajnim për kryerjen e vrojtimit "Mbetjet e Ngurta Urbane (Bashkiake)"

**Drejtuar:** Znj. MAJLINDA QILIMI

**KRYETAR**

**BASHKIA DELVINË**

E nderuar Znj. Qilimi,

Instituti i Statistikave, INSTAT, është institucioni zyrtar për marrjen dhe publikimin e të dhënave statistikore bazuar në Ligjin Nr. 17/2018, "Për Statistikat Zyrtare", dhe në "Programin Statistikor Kombëtar të Statistikave Zyrtare 2017-2021". Në përputhje me Nenin 31, të Ligjit Nr. 17/2018, "Për Statistikat Zyrtare", INSTAT garanton përdorimin e të dhënave vetëm për qëllime statistikore si dhe ruajtjen e konfidencialitetit.

Instituti i Statistikave gjatë muajt Qershor 2020, do të zhvillojë mbledhjen e të dhënave mbi anketën e "Mbetjeve të Ngurta Urbane", i cili sigurohet nga informacioni që disponojnë bashkitë. Grumbullimi informacionit do të kryhet nëpërmjet metodës inovative të mbledhjes së të dhënave "web interview" (plotësimi i pyetësorit online) në sistemin e ngritur nga INSTAT.

Informacioni i Bashkisë Delvinë është një burim shumë i rëndësishëm për nxjerrjen e të dhënave sasiore mbi mbetjet e ngurta urbane në të gjitha hallkat kryesore të zinxhirit ekzistencial të mbetjeve, nga gjenerimi deri në destinacionin përfundimtar të tyre. Publikimi i këtyre të dhënave do të jetë disponibël për publikun në faqen zyrtare [www.instat.gov.al](http://www.instat.gov.al)

Për përmbajtjen e vrojtimit, definicionet, konceptet si dhe mënyrën e plotësimit të pyetësorit, INSTAT do të organizojë një trajnim online me personat e kontaktit, përfaqësues të bashkisë suaj dhe përgjegjës për informacionin mbi mbetjet e ngurta bashkiake.

Personi që do të propozohet nga Ju si pikë kontakti, do të kontakohet nga INSTAT për t'u informuar rreth specifikave të trajnimit si dhe për t'u pajisur me kredencialet e nevojshme për të aksesuar pyetësorin.

Lutemi nga ana juaj të na vini në dispozicion informacion mbi emrin, mbiemrin, numrin e telefonit si dhe adresën e postës elektronike të personit të caktuar, brenda datës 22 Maj 2020, me shkresë zyrtare si dhe në adresën e postës elektronike [info@instat.gov.al](mailto:info@instat.gov.al).

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin, ju bëjmë me dije se pranë INSTAT do të gjeni gatishmëri për ndërtimin e një partneriteti të qendrueshëm.

**ZËVENDËSKRYETAR I BORDIT DREJTUES**

**ELSA DHULI**



**INSTITUTI I STATISTIKAVE**

Rr. Villazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Tiranë, Kodë Postar 1017  
Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Faks: +355 (4) 2 228300  
[www.instat.gov.al](http://www.instat.gov.al)